



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.417/23
Dt.16.06.2023

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), si dhe bazuar në ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32) dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog merr këtë:

VENDIM

**PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET
PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOMUNËN E ISTOGUT**

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Istogut mundë të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP), të Komunës së Istogut.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve.
3. Moshë minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP e përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit të shërbimit.
4. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i pa punësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njeri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prind punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njeri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjeri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i pa punësuar	30
12	Fëmijët e veteraneve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteraneve të luftës së UÇK-së nëse njeri prind punon	15
14	Fëmijët e veteraneve të luftës se UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	10
15	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	20
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	40
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	20
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	15
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore mbi 1000 euro)	10
20	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen – Bashkësitë Lokale ku gjendet IP-ja	20
21	Fëmijët e punëtoreve të IP-së	20
22	Fëmijët e prindërve që tashme kane një fëmijë vijues në IP	10
23	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	20
24	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	15
25	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	10
26	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore mbi 1000 euro)	5

5. Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante.

6 Ky vendim hynë në fuqi me njëhere

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen IP, Komisioni për zgjedhës dhe një kopje në arkivin e këtij institucioni.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Behlulaj